



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 42/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.42/2025, e datës 25.12.2025, parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 25.12.2025 në PZAP-i, është parashtruar ankesë nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se aktivistëve e saj kanë vërejtur një video të kandidates për deputete Fitore Pacolli, e cila promovon një shtand-shtëpizë me material zgjedhore të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të vendosur në hapësirë publike në Lagjen Dardania, konkretisht në pjesën e poshtme të Kurrizit, për të cilën shtëpizë pretendojmë se Subjekti LVV nuk ka leje/pëlqim nga Komuna e Prishtinës, respektivisht organi kompetent komunal - Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Më tej në ankesë pretendohet se Subjekti Politik LVV, ka bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të ligjit NR. 08/L228 për Zgjedhjet e Përgjithshme Republikën e Kosovës, sepse pa pëlqimin e organit kompetent ka vendosur material zgjedhore dhe ka promovuar fushatë politike përmes shtëpizës-shtandit që shihet në videon e bashkëngjitur si provë. Kërkojnë nga PZAP që të dënoj më gjorbë subjektin LVV dhe ta obligoj që të njëjtin ta largoj nga ajo hapësirë.

Si provë ka bashkëngjitur video incizim- CD.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LVV, sqarojnë se aktivitetet e Subjektit Politik Lëvizja VETËVENDOSJE!, përfshirë vendosjen e shtandeve zgjedhore, janë zhvilluar në

kuadër të fushatës zgjedhore dhe janë të njoftuara dhe të koordinuara me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), përmes formularit zyrtar për njoftimin e tubimeve politike, i cili mbulon periudhën dhe lokacionet e përmendura në ankesë. Po ashtu, Policia e Kosovës është njoftuar zyrtarisht për këto aktivitete, me qëllim të garantimit të rendit dhe sigurisë publike.

Tutje në përgjigje shtojnë se LZP dhe rregulloret zgjedhore në fuqi, nuk parashohin detyrim për pajisje me leje administrative komunale për vendosjen e shtandeve zgjedhore, përderisa aktiviteti është pjesë e fushatës zgjedhore dhe është i koordinuar me organet kompetente zgjedhore. Çështjet eventuale të natyrës administrative komunale nuk përbëjnë shkelje zgjedhore dhe nuk bien në kompetencën materiale të PZAP-it.

Për rrjedhojë, duke marrë parasysh paqëndrueshmërinë dhe paqartësinë e objektit të ankesës, si dhe faktin se aktivitetet janë zhvilluar në përputhje me procedurat zgjedhore dhe në koordinim me institucionet përkatëse, konsiderojnë se nuk janë përmbushur elementet e shkeljes së pretenduar zgjedhore.

Kërkojnë nga PZAP-i, që ankesën ta refuzojë si të pabazuar dhe të konstatojë se në rastin konkret nuk ka pasur shkelje të dispozitave që rregullojnë fushatën zgjedhore.

Prova: Fotografitë e dokumenteve të bashkëngjitura

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

- *Ankesa është e pa bazuar*

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtuesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkëngjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, Formulari i Njoftimit për tubim politik si dhe komunikimin përmes email-it në mes të Policisë së Kosovës dhe KKZ-së në Prishtinë, lidhur me lajmërimin e tubimeve dhe vendosjen e shtandeve, vërtetoi se vendosja e shtandit nga Subjekti Politik LVV, është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike, konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.42/2025 më datën 26.12.2025



Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.